

1. Eksperienca në Fushën e Ndërtimit

a. Tenderuesit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Të ardhurat mesatare vjetore si kontraktor kryesor (faturimi për punë në progres ose të përfunduar) gjatë pesë viteve të fundit prej 10,000,000 Euro dhe

b. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën një projekti në fushën e ndërtimit me një vlerë prej 6,300,000 Euro, ose disa projekteve me vlerë prej 25,200,000 Euro me natyrë dhe kompleksitet të krahasueshëm me punët e propozuara, që kanë përfunduar me sukses. Në këto projekte tenderuesi duhet të ketë qenë kontraktori kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose i nënkontraktuar, brenda pesë viteve të fundit.

2. Eksperienca në Ndërtimin e Rrugëve

Ofertuesi ose një nënkontraktor i specializuar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Qarkullimi mesatar vjetor si kontraktor kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose si i nënkontraktuar (për vepra rrugore në progres ose të përfunduara) gjatë pesë viteve të fundit, duhet të ketë vlerën 2.700.000 Euro.

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën një projekti rruge me një vlerë prej 700.000 Euro, ose të disa rrugëve me një vlerë prej 2.800.000 Euro të natyrës dhe kompleksitetit të krahasueshëm me punët e propozuara që kanë përfunduar me sukses. Në këto projekte tenderuesi duhet të ketë qenë kontraktori kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose i nënkontraktuar, brenda pesë viteve të fundit.

3. Përvojë Operacionale dhe Mirëmbajtjeje

Tenderuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme :

a.mbi operimin e një stacioni të transportit publik të natyrës dhe kompleksitetit të krahasueshëm me Projektin e propozuar, dhe

b.Qarkullimi mesatar vjetor si kontraktor kryesor (pagesa totale të marra për operimin dhe menaxhimin e shërbimeve të transportit publik ose privat ose përvoja e shërbimeve të niveleve të larta të mirëmbajtjes nga Operatori Ekonomik ofertues, pjesëtuar me numrin e viteve) gjatë pesë viteve të fundit të jetë në vlerën 1,200,000 Euro.

c.Përvojë e suksesshme në operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të patundshme të të paktën një projekti të mirëmbajtjes me një vlerë vjetore prej 300,000 Euro, ose të disa projekteve të mirëmbajtjes me një vlerë vjetore prej 1,200,000 Euro, të natyrës dhe kompleksitetit të krahasueshëm me punët e propozuara që kanë përfunduar me sukses. Në këto projekte tenderuesi duhet të ketë qenë kontraktori kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose i nënkontraktuar, brenda pesë viteve të fundit.

4. Eksperienca në Fushën e Projektimit

Ofertuesi ose një nënkontraktor i specializuar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Qarkullimi mesatar vjetor si kontraktor kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose i nënkontraktuar, brenda pesë viteve të fundit me vlerë prej 200.000 Euro.

Përvojë e suksesshme si kontraktor kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose i nënkontraktuar në hartimin e të paktën një projekti me vlerë: 175,000 Euro, ose të disa projekteve në një vlerë prej 700,000 Euro të natyrës dhe kompleksitetit të krahasueshëm me punët e propozuara që kanë përfunduar me sukses. Në këto projekte tenderuesi duhet të ketë qenë kontraktori kryesor, anëtar i një Partneriteti, ose i nënkontraktuar, brenda pesë viteve të fundit.

5. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë kopje të Audituar dhe Certifikuara të Bilancit, ose në qoftë se nuk kërkohet nga ligjet e vendit tenderues, pasqyra të tjera financiare të pranueshme për Autoritetin Kontraktor, për pesë vitet e fundit. Pasqyrat financiare duhet të dorëzohen dhe të demostrojnë qëndrueshmërinë aktuale të gjendjes financiare të tenderuesit dhe të tregojnë rentabilitetin e tij të ardhshëm afatgjatë. Kur është e nevojshme, Autoriteti Kontraktues do të kontaktojë me Bankat e tenderuesit.

Tenderuesi duhet të tregojë se ka në dispozicion aktive likuide, si dhe mjete të tjera financiare, të vlerësuara jo më pak se Kapaciteti ekonomik dhe financiar.

Tenderuesi duhet të tregojë se ka në dispozicion aktive likuide, si dhe mjete të tjera financiare, të vlerësuara jo më pak se 3 500 000 Euro, të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e kontratës për likuiditet për një periudhë 5 mujore

Tenderuesi duhet të paraqesë përpara Autoritetit Kontraktor, dokumenta që dëshmojnë se zotëron burime shtesë financiare, për të përmbushur kërkesat për likuiditet gjatë ekzekutimit të përmbushjes së gjithë fazave të kontratës.

6. Deklarata gjyqësore

Tenderuesi duhet të paraqesë në dokumentat e aplikimit, informacion të saktë mbi mospërfshirjen në ndonjë çështje gjyqësore apo arbitrazhi, aktuale ose të shkuar që rrjedhin nga kontratat e përfunduara ose në ekzekutim prej tij gjatë pesë viteve të fundit. Të gjithë tenderuesit duhet të shoqërohen me një sigurim të ofertës prej 300.000 Euro, dhe do të jetë i ngarkuar në adresën zyrtare të APP-së: ëëë.app.gov.al, jo më vonë se data 07.11.2016, në orën 12:00 (mesditë), Tiranë.